

Development and Implementation of MDTV Curricula (DIMTV)

WP5 - Activity 5.1

Relacion mbi takimet e Steering Committee

Project Duration: Oct 2017 – Oct 2020 (Extended to October 2021)

Start Date of Deliverable: January 2018

Submission Date: September 2021

Dissemination level: Department/Faculty, Local, National, Institutional

Lead Organization: UAMD

Ky dokument do të bëj një përmbledhje të takimet të grupit drejtues të projektit (Steering committee) gjatë 4 viteve të projektit.

Takimi I parë i grupit drejtues u zhvillua në takimin e parë prezantues dhe iniciues të aktiviteteve të projektit që u zhvillua në 9 janar 2018 në ambjentet e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës. Gjatë takimit të parë u përzgjedhën anëtarët e bordit drejtues dhe në tabelën e mëposhtme gjendet lista e tyre:

1	Albana Halili	UAMD
2	Lindita Mukli	UAMD
3	Endri Stoja	EPOKA
4	Klajdi Bulku	RTSH
5	Mimoza Ibrani	UP
6	Naim Preniqi	UBT
7	Matevz Pogacnik	UL
8	Gholamreza Anbarjafari	UT
9	Miroslav Voznak	VSB-TUO

Takimi i dytë i bordit drejtues u zhvillua në 25 qershor të 2018 në Tiranë, në ambjentet e universitetit EPOKA. Aty morën pjesë të gjithë anëtarët e bordit dhe trajtuan çështje të menaxhimit të projektit kryesisht të tilla si :

- Organizimi i ditëve të hapura të DIMTV në universitete duke tentuar tërheqjen dhe ndërlidhjen me sa më shumë student potencialë.
- Përdorimi i medias publike për promovim të aktiviteteve të projektit
- Përgatitja e materialeve promovuese si bluza dhe postera.
- Përgatitja e materialeve multimediale për promovim
- Pjesëmarrja në panair pune.

Takimi i tretë i grupit drejtues u zhvillua në Lubjanë në 21-23 Janar 2019. Gjatë kësaj periudhe cdo përfaqësues i institucioneve pjesëmarrësve në konsortiumin e projektit prezantuan ecurinë e tyre të aktiviteteve, problematikave dhe planit të vazhdimësisë së secilit institucion për realizimin e objektivave në kuadër të projektit. Ndër të tjera në këtë takim u fol në lidhje me:

- Realizimin e disa aktiviteteve që kishin vonesë në kohë.
- Vlerësimi i programeve të studimit nga Universiteti i Ostravës.

- Përgatitja e planit të bashkëpunimit dhe gjetjen e formave të bashkëpunimit midis universitetit dhe industrisë, ku një nga qëllimet kryesore ishte dhe realizmi i praktikave mësimore të studentëve.
- Rëndësia e promovimit sidomos në rrjetet sociale.
- Cështje financiare dhe të buxhetit me secilin antar.

Takimi i katërt i bordit drejtues u mbajt në Prishtinë në Universitetin e Prishtinës dhe UBT, gjatë datave 26-27 shtator 2019.

Gjatë këtij takimi secili antar diskutoi në lidhje me ecurinë e implementimit të projektit në institucionin e tij dhe në kuadër të implementimit të të gjithë projektit tema të tilla si:

- Menaxhimi i financave të projektit, analiza e kategorive të buxhetit, shpenzimet mbi udhëtimet, orëve të punës, pajisjeve dhe mbi kontratat e paracaktuara. Dhe me dakortësinë e të gjithë pjesëmarrësve fokusi ishte zhvillimi i një plani qëndrueshmërie dhe vazhdimësie për cdo investim të realizuar deri më tani me mbështetjen e EU në kuadër të projektit.

Për shkak të pandemisë takimi i pestë dhe i gjashtë i bordit drejtues u zhvillua online në datën 18 Mars 2020. Të gjithë partnerët që kishin përgjegjësinë për realizimin e një pakete pune, duhet të përgatisnin një raport të shkruar mbi çfarë kishin arritur ata. Universiteti i Lubjanës dhe Universiteti i Ostravës dhanë këshilla apo udhëzime se si të arrihet tërheqja e sa më shumë palëve të interesuar për këtë program studimi dhe njëkohësisht rritja apo nxitja e bashkëpunimit me institucione të ndryshme. Bashkëpunimi me industrinë do të sigurojë dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. Për shkak të vazhdimësisë së situatës së COVID-19, bordi drejtues do të kërkojë shtyrjen e projektit dhe me minimum 6 muaj për shka se shumë aktivitete duhet të përfundonin.

Takimi i shtatë i grupit drejtues të projektit u zhvillua tek Universiteti i Prishtinës në korrik të 2021. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte sigurimi i cilësisë. Në këtë takim u diskutua kryesisht për tranzicionin e kohës së projektit të aprovuar tashmë dhe rezlimin e objektivave drejt finalizimit me kujdes të projektit.

Dhe takimi final (Takimi tetë) i bordit drejtues ishte ditën e dytë gjatë konferencës përmblyese të DIMTV ku fokusi ishte orgazinimi i dokumentacionit për auditin, pjesa e menaxhimit financiar dhe problematika të tejsra.

Bordi drejtues i DIMTV ka luajtur një rol tejet të rëndësishëm në implementimin e suksesshëm të projektit.